



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

REPUBLICA KOSOVA AGJENCIA ZA VAZDUSHO NAVIGACIJSKE USLUGE REPUBLIC OF KOSOVO AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E ARKIVES KANCELARIA E DEHTA OFFICE	
Nr. prot. Br. prot. Prot. no.	01 0372
Data Data	02.07.24 FM LIPJAN, RKS

Titulli: F-ZYDR-005
Data e Aprovimit: 01-05-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 1 nga 1

Nr. 46 / 2024

Datë: 02/07/2024

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, duke u bazuar në dispozitat e nenit 5 paragrafit 6 dhe nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si dhe dispozitat e nenit 53 dhe 55 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, merr këtë:

VENDIM

Për shfuqizim të Pëlqimit

- SHFUQIZOHET Pëlqimi i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror i lëshuar me numër protokolli 0311 i datës 19.07.2023 për dhënie të pëlqimit për qasje në rrugën lidhëse L6- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës me rrugën magjistrale M9, i lëshuar për pronarin Etrit Dumani.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Me pëlqimin me numër protokolli 0311 të datës 19.07.2023, pronarit Etrit Dumani (për parcelën e tij me numër 00887-1, Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë), i është dhënë qasje për kyçje në rrugën lidhëse L6, rrugë në pronësi të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Sh.A., që lidhë Aeroportin me magjistralen M9.

Bazuar në dispozitat e LPPA-së është konstatuar se pëlqimi i lartcekur është lëshuar për pronën e subjektit tjetër juridik - Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Sh.A., për të cilin ASHNA nuk ka pasur kompetencë dhe juridiksion.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të neneve 52, 53 dhe 55 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Samir BLLACAKU


Drejtor i ASHNA-së



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Komunës së Fushë Kosovës;
- Palës-z. Etrit Dumani;
- Arkivit-ASHNA.